

Maj 2025 | Nr. 49

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i Drejtësisë



@ILD_Albania



Inspektori i Lartë i Drejtësisë

RESIJ ME PRIORITETE TË REJA MBI BASHKËPUNIMIN
DY E SHUMË PALËSH DHE ME BE-NË





RESIJ ME PRIORITETE TË REJA MBI BASHKËPUNIMIN DY E SHUMË PALËSH DHE ME BE-NË

Lisbonë, 22-23 Maj 2025

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të RESIJ, Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, ku ILD është anëtar.

Eventi u mikprit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i Portugalisë me praninë e shërbimeve të inspektimit të vendeve anëtare të RESIJ, Belgjika, Bullgaria, Franca, Italia, Portugalia, Spanja, Shqipëria dhe Moldavia, e cila prej vitit të kaluar

mban statusin e vëzhguesit në këtë rrjet. Asambleja diskutoi mbi çështje të brendshme të ndryshimeve në statutin e RESIJ, identifikimin e masave procedurale për të lehtësuar ndryshime efektive, mbi nivelin e autoritetit të përfaqësimit të secilit vend anëtar, për të patur transparencë dhe koherencë institucionale.

Në Asamble u bë zgjedhja e presidentit të ri të RESIJ, me konstatimin e përfundimit të mandatit nga Rumania. Me votat unanime të të gjithë anëtarëve, u votua kandidatura e Francës, e z. Stephane Noël,



shafi i Inspektoratit të Drejtësisë së Francës. fokusuan edhe në pritshmëritë konkrete të Franca, themeluese e Rrjetit RESIJ merr për secilin nga Rrjeti për të ardhmen, si dhe të dytën herë Presidencën e këtij Rrjeti. bashkëpunimin me institucionet evropiane Diskutimet e anëtarëve gjatë Asamblesë u për ndarjen e eksperiencave dhe



Asambleja zgjodhi presidentin e ri të RESIJ, me konstatimin e përfundimit të mandatit nga Rumania. Me votat unanime të të gjithë anëtarëve, u votua kandidatura e Francës, e z. Stephane Noël, shefi i Inspektoratit të Drejtësisë së Francës. Franca, themeluese e Rrjetit RESIJ merr për të dytën herë Presidencën e këtij Rrjeti.

ekspertizës, në funksion të rritjes së efikasitetit të drejtësisë, duke qenë në një linjë me direktivat e Bashkimit Evropian. ekspertizës, në funksion të rritjes së efikasitetit të drejtësisë, duke qenë në një linjë me direktivat e Bashkimit Evropian.

Të ftuar në këtë mbledhje të RESIJ ishin shërbimet e inspektimit portugez të Prokuro-

risë, të Gjykatave Administrative, të ndihmësve gjyqësorë dhe të Ministrisë së Drejtësisë, që bënë prezantime të funksioneve të tyre të punës për monitorimin e sistemit të drejtësisë në Portugali.



FOTO NGA PUNIMET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË RESIJ





KONFERENCA “TË KOMUNIKOSH DREJTË SINË”

Në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të RESIJ, Këshilli i Lartë Gjyqësor i Portugalisë organizoi konferencën me titull “Të komunikosh drejtësinë”, që u mbajt në sallën plenare të Gjykatës së Lartë në Lisbonë.

Në përshëndetjen e tij, nënkryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, magjistrati Luiz Azevedo Mendes evidentoi faktin se komunikimi i drejtësisë duhet të përmbajë qartësi dhe thjeshtësi, sepse të kuptuarit e vendimeve lidhet me besimin publik tek sistemi dhe drejtësia dhe RESIJ e ka temë diskutimi të vetën.

Temat e konferencës trajtuan rolin e inspektimit gjyqësor në promovimin e qartësisë dhe të transparencës së vendimeve gjyqësore; argumentimi, gjuha dhe komunikimi në vendimet gjyqësore; komunikimi i drejtësisë në kontekstin e medias: mbrojtja e të dhënave, anonimizimi i vendimeve gjyqësore; inteligjenca artificiale dhe interesi i publikut, liria e shprehjes dhe e informacionit; sfida të reja dhe avantazhe në përdorimin e mjeteve të teknologjisë dhe të inteligjencës artificiale në hartimin e vendimeve dhe realizimin e inspektimeve gjyqësore.

FOTO NGA KONFERENCA “TË KOMUNIKOSH DREJTËSINË”
NË LISBONË



MAJI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Maj 2025** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **135 të depozituara vetëm nga qytetarë**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Maj 2025**.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
78 vendime nga 206 praktika të trajtuara: • 55 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar; • 23 vendime arkivimi pas Verifikimit	• 17 vendime verifikimi	• 3 vendime fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrate (gjyqtar); 2 magjistratë (prokurorë) • 1 vendim për mbyllje hetimi disiplinor për 1 magjistrat (gjyqtar)

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD,


në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Maj** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, **për 5 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.






Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit **Maj 2025**,
Sektori i Ankesave dhe
Marrëdhënieve me Publikun:

- ⇒ **ka pritur 33 ankues,**
të cilët janë paraqitur në ambi-
entet e Zyrës së Inspektorit të
Lartë të Drejtësisë;
- ⇒ **ka realizuar 10 telefonata me**
qytetarë, të cilët kanë
kërkuar informacion mbi
fazën e ankesave të tyre ose
Informacion mbi plotësimin e
formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Maj 2025**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **18 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ILD NË TWITTER

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · May 24 · ·

General Assembly of #RESIJ new common aspirations. Congratulations to our new President, Mr. Stephane Noël, head of #IGJ #servicesofinspection #justice #magistrates #HIJ



1 3 164

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · May 22 · ·

Conference "Communicating Justice" Being clear and being simple. #RESIJ #CSM #SupremeCourt



1 4 153

·

Përpunimi i javor i ankesave #ILD

- 7464 të konfirmuara
- 5969 Ankesa të trajtuara
- 1495 Ankesa në proces trajtimi
- 148 Ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar
- 137 magjistratë të hetuar
- 49 kërkesa për procedim disiplinor
- Më shumë ild.al




Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · May 19

·

Përpunimi i javor i ankesave #ILD

- 7416 të konfirmuara
- 5959 Ankesa të trajtuara
- 1457 Ankesa në proces trajtimi
- 151 Ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar
- 137 magjistratë të hetuar
- 49 kërkesa për procedim disiplinor
- Më shumë ild.al




2 58

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania ·

Përpunimi i javor i ankesave në #ILD

- Ankesa të konfirmuara
- Ankesa të trajtuara
- Ankesa në proces trajtimi
- Ankesa në proces verifikimi
- Magjistratë të hetuar
- Kërkesa për procedim disiplinor
- Më shumë ild.al



1 2 119



Maj 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara

© ILD


**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al

Tel: +35542217217

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD

Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

[youtube.com](https://www.youtube.com)

*[Kliko](#) për të ndjekur spotin
prezantues të ILD*



Më skano!